



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Ekstrakt

Nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me qytetarët e fshatit Shajkoc, mbajtur më dt.18.06.2020.

Takimi filloi në orën 14:06, dhe u mbajt në SHFMU “Hasan Ramadani”, në fshatin “Shajkoc”. Takimin e hapi dhe e kryesoi z.Ramush Jupolli përfaqësues i fshatit, fillimisht shpreh falënderimet sa i përket investimeve në fshatin “Shajkoc”, falënderon gjithë të pranishmit dhe para pjesëmarrësve prezanton Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës së Podujevës dhe atë: Isuf Latifi drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i shoqëruar nga Vezir Januzi drejtor Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, Hamdi Jaha drejtor Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi drejtor Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Durim Salihu Drejtoria e Inspeksionit.

Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë evidentuar dhe nënshkruar në listën për pjesëmarrje e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Tema: Dëgjim Buxhetor rreth përgatitjes së propozim Buxhetit të Komunës për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021/23.

z.Ramush Jupolli përfaqësues i fshatit “Shajkoc” fillimisht shpreh falënderimet sa i përket investimeve në fshat, falënderon gjithë të pranishmit për pjesëmarrje që e vlerëson mjaft të rëndësishëm këtë takim për lokalitetin e kësaj ane, njofton gjithë të pranishmit se Komuna e Podujevës zhvillon si çdo vit edhe këtë vit procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm dhe prioritetet për dy vitet në vijim dhe prezanton para të pranishmëve Drejtorët e Drejtorive të Administratës së “Komunës së Podujevës” dhe atë Isuf Latifi drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i shoqëruar nga Vezir Januzi drejtor Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, Hamdi Jaha drejtor Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi drejtor Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Durim Salihu Drejtoria e Inspeksionit, dhe fjalën ia kalon.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF ndër të tjera theksoi, ju falënderoi të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj nuk e kemi përzgjedhë rastësisht “Shajkocin”, përkundrazi rrethanave të krijuara nga pandemia “Covid-19”.

Prej 15 maji fillon planifikimi i buxhetit për tri vite dhe përfundon më 30 shtator, ne mundohemi me i marrë kërkesat e qytetarëve brenda kësaj periudhe kohore që t’i realizojmë në të ardhmen, këtë vit për shkak të pandemisë Covid-19 buxheti është më i ulët për shkak të hyrave më të vogla si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia “Covid-19”.

Sot kemi ardhë për të dëgjuar kërkesat e juaja që së paku deri në shtator për të pasur mundësi me i inkorporuar si projekte në kuadër të kornizës afatmesme buxhetore.

z.Arsim Agushi, nga fshati “Shajkoc”, përfaqësues i lagjes “Përvetica” theksoi, jemi 16 shtëpi si përfaqësues i 16 shtëpive kam këto kërkesa:

- Rrjetin e kanalizimit 200 metra.
- Asfaltimin e dy rrugë me gjatësi 200 metra.

Për momentin me urgjencë është rrjeti i kanalizimit sepse nuk kemi kyçje në rrjetin e kanalizimit me lagjen tjetër të fshatit, rrugët nuk janë urgjente.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF jep sqarime parafolësit, kërkesat e juaja i kemi për bazë këtu është edhe drejtori Faik dhe së bashku do i shqyrtojmë kërkesat e juaja brenda mundësive buxhetore që na i lejon korniza buxhetore.

z.Fatmir Jupolli, nga fshati “Shajkoc”, paraqiti kërkesat

-Ndriçimin e fshatit në të gjitha lagjet.

-Asfaltimin e dy rrugëve të reja në fshat të cilat janë në pronësi private.

z.Patriot Rudari, asamblist i fshatit “Shajkoc” paraqiti kërkesat:

-Shtirirjen e rrjetit të kanalizimit në lagjen “Jupolli” për tri familjet “Kurtolli” pa kyçje në rrjetin e kanalizimit.

-Largimin e deponisë së mbeturinave.

z.Ramush Jupolli përfaqësues i fshatit “Shajkoc”, jep sqarim parafolësit, çështja është shpuarja e asfaltit për kyçjen e tri familjeve në rrjetin e kanalizimit.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF jep sqarime parafolësit, kërkesat e juaja i kemi për bazë ato rrugë të cilat ju i çekët duhet të shpronësohen të kalojnë në procedurë për kthimin në pronë publike.

z.Rrahim Musolli, nga fshati “Shajkoc”, paraqiti kërkesat:

-Rregullimin e gypave të kanalizimit që janë mbi tokë te rruga lidhëse mes livadheve dhe “Xhamisë” së fshatit.

-Asfaltimin e një pjese të kësaj rruge me gjatësi 30 metra.

z.Hamdi Jaha, drejtor DPUMM jep sqarime parafolëseve, këtë vit në “Shajkoc” janë në projekt 3 km rrugë për t’u asfaltuar, nuk do të mbet asnjë rrugë pa u asfaltuar, nëse do të kemi mundësi buxhetore edhe ajo pjesë do të asfaltohet.

Sa i përket kërkesave ato duhet të jenë të kjarta, projektet që i kemi në fshatin “Shajkoc” janë: pjesa e poshtme në lagjen “Kosumi” në lagjet “Jupolli”, “Musolli” dhe “Mulolli” dhe dy rrugët te lagjet “Mulolli” dhe “Durmishi”, po ashtu edhe në lagjet “Agushi” dhe “Mehmeti” janë në projekt të gjitha do të përfundojnë brenda dy viteve, ne nuk kemi mundësi me bë edhe ndriçimin e fshatit dhe trotuaret e fshatit.

z.Fatmir Jupolli, nga fshati “Shajkoc”, paraqiti kërkesë:

-Vendosjen e dy pengesave në rrugën kryesore të fshatit.

z.Ramush Jupolli përfaqësues i fshatit “Shajkoc”, jep sqarime parafolësit, kemi bërë kërkesë së bashku me drejtorin në Ministri dhe presim përgjigjen e Ministrisë për vendosjen e pengesave.

z.Hamdi Jaha, drejtor DPUMM jep sqarime parafolësit, nuk janë në domenin tonë vendosja e pengesave, ne do të bashkëpunojmë me MTI-në për sigurinë e qytetarëve lidhur me kërkesën tuaj.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH jep disa sqarime për projektet në fshatin “Shajkoc”, trotuar 510 metër janë në projekt, sa i përket kërkesës tuaja për ndriçim ju niftoi se ndriçimi është paraparë për vitin e ardhshëm që është paraparë për fshatrat “Balloc”, “Lladoc”, “Sfeçël”, “Shajkoc” faza e parë rruga kryesore, rrjeti i kanalizimit në lagjen “Obrazhda”, me gjatësi 2 km faza e parë përfundon këtë vit, te varrezat ka mbet një pjesë pa u shtruar në kubëza, projekti i ujësjellësi është në kontratë me gjatësi 510 metër.

z.Bajram Mulolli, drejtor i shkollës fshati “Shajkoc”, paraqiti kërkesë:

-Asfaltimin e rrugës përballë “Ardi Net”, në gjatësi 150 metër ose që ka mundësi edhe në kubëza.

z.Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH jep disa sqarime parafolësit, projektet që hyjnë brenda kornizave buxhetore janë ndriçimi dhe asfaltimi i rrugëve.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF jep sqarim parafolësve kërkesat e juaja i parashtroni në formë fizike, Ramushi i drejton ato në drejtoritë përkatëse brenda periudhës kohore 15 maj- 30 shtator, është afati kohor ku ne i marrim kërkesat.

Në emër të përfaqësuesit të fshatit ju mundeni me i parashtruar kërkesat dhe përmes asamblistit të fshatit z.Patriot Rudari.

Rrugët kryesore dhe kanalizimet kanë përfunduar sot fatmirësisht me kontributet e juaja kemi investuar në “Shajkoc” dhe në të gjithë Komunën e Podujevës, 78 fshatrat dhe qytetin me i trajtuar me 6 milion euro është shumë vështirë, po mundohemi të jemi sa më real në punët tona në të gjithë fshatrat, mendoni që ne e kemi përgjegjësinë për të gjithë që t’i trajtojmë njësoi pa dallime, është e pa mundur që në 78 fshatra të punojmë përnjëherë, për fund ju falënderoi të gjithëve për pjesëmarrje.

Z.Vezir Januzi, drejtor DBPZHR ndër të tjera theksoi, ju dëgjova me vëmendje nuk e di deri kur do vazhdojmë me kërkesa kur dihet se çfarë kushtesh të mira ka “Shajkoci” me rrethinë për zhvillimin e bujqësisë, ne si drejtori jemi në dispozicion me ju ndihmua secilit qytetarë lidhur me subvencionimin e bujqësisë, thirrja ime është fokusohuni më shumë kah bujqësia se sa kah infrastruktura sepse bujqësia është sektori ku gjerohen vende të reja të punës.

z.Arsim Agushi, nga fshati “Shajkoc”, përfaqësues i lagjes “Përvetica”, jep sqarime parafolësit, gjërat më elementare se serrën kultivatorin etj, kemi infrastrukturën rrugore.

z.Bajram Mulolli, drejtor i shkollës fshati “Shajkoc”, paraqiti kërkesë:

-Ndërtimin e ri të objektit të shkollës.

z.Ramush Jupolli përfaqësues i fshatit “Shajkoc”, i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në takim, ne i morëm të gjitha kërkesat e juaja dhe për disa veç se u dhanë sqarime, të përfshirjes së tyre në planifikimet tre vjeçare buxhetore të Komunës, andaj me kaq e konstatoi të mbyllur këtë takim.

Takimi përfundoi në orën 14:50.

Procesverbalin e mbajti:

Osman Bajrami

Nr.prot. 04-400/01-0030192/20

Podujevë

18.06.2020

Drejtori i DBF

Isuf Latifi